

I nderuar Z. Matlija,

Në përgjigje të kërkesës suaj, dërguar pranë institucionit të Kryeministrit, bazuar në ligjin nr.119/2014, datë 18.9.2014 "Për të drejtën e informimit", sipas së cilës kërkoni informacion në lidhje me vlerën e shpenzimeve mujore për ndezjen dhe mirëmbajtjen e veprës "Marquee Tirana", të instaluar mbi fasadën e Kryeministrit, ju informojmë se ky objekt është pjesë e integruar e ndërtesës së institucionit dhe nuk disponon një sahat matës të energjisë elektrike, të veçuar nga pjesa tjetër e institucionit. Për këtë arsye, është e pamundur të veçohet vlera e shpenzimeve mujore për ndezjen dhe funksionimin e tij nga vlera totale e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe te punes qe kryehet në ndërtesën e insitucionit të Kryeministrit.

Për çdo kërkesë të mëtejshme apo sqarim të nevojshëm, jeni të mirëpritur t'i paraqisni ato pranë institucionit të Kryeministrit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,